

L I G J

Nr. 8103, datë 28.3.1996

**PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT
ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I :

Neni 1

Miratohet privatizimi i sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të përdorura.

Neni 2

Privatizimit mund t'i nënshtrohen të gjitha pjesët përbërëse të sistemit të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të përdorura, si dhe shërbimet që lidhen me to.

Neni 3

Procedurat, koha dhe mënyrat e privatizimit të shoqërive të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të përdorura përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit dhe të Ministrisë së Financave.

Formula e privatizimit të aseteve të ndërmarrjeve të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të përdorura do të miratohet me ligj të veçantë.

Neni 4

Rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet Këshillit të Ministrave, sektorit privat në furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të përdorura dhe konsumatorit bëhet nga Enti Rregullator, veprimtaria e të cilit miratohet me ligj të veçantë.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 1449, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.